

NE EMER TE POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal, me Gjyqtarin Mustaf Tahiri, duke vendosur në lëndën penale ndaj të pandehurit [REDAKTUAR], me vendbanim në fshatin [REDAKTUAR] Komuna Kaçanik, për shkak të veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-ës, duke vendosur lidhur me Aktakuzën e Prokurorisë Themelore ne Ferizaj, Departamenti i përgjithshëm PP.II.nr.1109-1/2017, dt.07.11.2017, dhe kërkesën për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor të paraqitur në Aktakuze, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me datë 21.12.2017, merrë këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore ne Ferizaj Departamenti i përgjithshëm PP.II.nr.1109-1/2017, dt.07.11.2017, dhe kjo Gjykate i jep këtë;

URDHER NDESHKIMOR

I akuzuari; [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR] i lindur me datën [REDAKTUAR], me vendbanim në fshatin [REDAKTUAR] Komuna Kaçanik, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal [REDAKTUAR], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datë 26.04.2017, rreth orës 17:00, në rrugën “Mustafë Goga”, Ferizaj, i pandehuri ka dëmtuar pasurinë e personit tjetër, i pandehuri si mbikëqyrës i punimeve në firmën “[REDAKTUAR]”, në atë mënyrë që derisa ishte me një grup punëtorë duke bërë rrënimin e mureve të zyreve, kanë hedhur mbeturina copash betoni dhe tjegulla në pusin, pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR], ku ka dëmtuar gypat dhe nxehjen e pjesës ku nxjerrët uji, me ç’rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material,-

Me çka ka kryer veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-ës.

Andaj gjykata ne baze te nenit 4, 7, 17, 41, 46, 73, te KPRK-se, dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366, te KPP-se i;

SHQIPTON

DENIMIN ME GJOBË në shumë prej 200 € (dyqindeuro), të cilin dënim do ta paguaj pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veproj në bazë të nenit 46 te KPRK-se, në zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur 20 € për një ditë të kaluar me burg.

Obliqohet i akuzuari që në emër te paushallit gjyqësorë te paguaj shumën prej 20€ (njëzet euro), ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari: [REDAKTUAR] me vendbanim në rrugën [REDAKTUAR] kati [REDAKTUAR] nr. [REDAKTUAR] Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridikë udhëzohen ne kontestin civil juridik.

Arsyetim

Prokuroria Themelore ne Ferizaj Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar Aktakuzën PP.II.nr.1109-1/2017, dt.07.11.2017, se bashku me kërkesën për shqiptimin e urdhrin ndëshkëmor, kundër te akuzuarit, [REDAKTUAR], me vendbanim në fshatin [REDAKTUAR] Komuna Kaçanik, për shkak të veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-ës.

Gjykata shqyrtoj Aktakuzën dhe kërkesën për shqiptimin e urdhrin ndëshkëmor dhe gjeti se Aktakuza dhe kërkesa janë të bazuar ne baze te nenit 495 te KPP-se, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPP-ës, që pa u mbajtur shqyrtimi gjyqësor të merr vendim për urdhër ndëshkëmorë si në dispozitiv, pasi qe nga shkresat e lëndës vërtetohet se ka prova të mjaftueshme, të cilat vërtetojnë fajësinë e te akuzuarit se ka kryer veprën penale e cila i vihen në barrë sipas aktakuzës së Prokurorisë dhe atë deklarata e të pandehurit e dt.26.04.2017, deklarata e të dëmtuarit e dt.26.04.2017 si dhe fotografitë dhe shkresat tjera të lëndës.

Sipas KPRK-se, vepra penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-ës, është vepër penale e dënueshme me burgim deri në një (1) vit,

Gjykata në përputhje me nenin 73 të KPRK-së, me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë, mori për bazë gjendjen materiale dhe kushtet ekonomike për te akuzuarin, vlerësoj se një dënim i tille është adekuat dhe është i përballueshëm në raport me gjendjen e tij ekonomike dhe me këtë dënim do te arrihet qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 41 te KPRK-ës, pasi qe njëra nga qëllimet e dënimit është te parandaloje kryesin nga kryerja e veprave penale ne te ardhmen dhe te beje rehabilitimin e tij dhe se te përmbajë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.


Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, gjykata e mori komfor nenit 450 të KPP-ës.

Ne mbështetje te nenit 463 te KPP-se, palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridikë janë udhëzuar ne kontestin civile juridik.

Nga theksimet si me lartë u vendos si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal
P.nr.2836/2017 dt.21.12.2017

Gjyqtari
Mustaf Tahiri



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, gjyqtarit individual të kësaj gjykate. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhri ndëshkëmorë merr formën e prerë.

REPUBLICA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA
21.12.17
VENDIMI ËSHTË I PLOTËFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC

Më: 20-03-2018
Qana